



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: 07.01.2025

Nr: 3

**URDHËR**

**PËR**

**MIRATIMIN E POLITIKAVE TË PRIVATËSISË TË PLATFORMËS ELEKTRONIKE  
TË REGJISTRIMIT (PER) TË ZGJEDHËSVE NGA JASHTË VENDIT, SI DHE  
DEKLARATËS SË KONFIDENCIALITETIT PËR RUAJTJEN E TË DHËNAVE  
PERSONALE**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të ndryshuar, vendimit nr. 10, datë 23.10.2024 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe përgatitjen e listës së zgjedhësve”, dhe vendimit nr. 194, datë 7.11.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për rregullat teknike të administrimit, nëpërmjet “PER”-it, të kërkesave për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”,

**VENDOS:**

1. Miratimin e politikave të privatësisë të Platformës Elektronike të Regjistrimit (PER), sipas lidhjes 1 që i bashkëlidhet këtij urdhri.
2. Miratimin e deklaratës së konfidencialitetit të ruajtjes së të dhënave personale, sipas lidhjes 2 që i bashkëlidhet këtij urdhri.
3. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Illirjan CELIBASHI**

Data: 7.1.2025

Nr:3



Për miratimin e politikave të privatësisë të Platformës Elektronike të Regjistrimit (PER) të zgjedhësve nga jashtë vendit, si dhe deklaratës së konfidencialitetit për ruajtjen e të dhënave personale.

# **POLITIKA E PRIVATËSISË E PROCESIT TË VOTIMIT NGA JASHTË VENDIT DHE PLATFORMËS ELEKTRONIKE TË REGJISTRIMIT (PER)**

## **Hyrje dhe Qëllimi i Dokumentit**

Kjo politikë privatësie ka për qëllim të informojë për rregullat dhe masat e nevojshme për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve që regjistrohen në Platformën Elektronike të Regjistrimit (PER), si dhe për proceset pasuese të dergimit të votave me postë, administrimin dhe ruajtjen e të dhënave personale që shoqërojnë këtë proces.

Përdorimi i PER dhe pjesëmarrja në proceset zgjedhore nënkupton që përdoruesit pajtohen me këto rregulla dhe politika.

## **RREGULLA TË PËRGJITHSHME**

Zgjedhësi që dëshiron të votojë nga jashtë vendit paraqet kërkesë në mënyrë individuale për regjistrim në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit përmes Platformës Elektronike të Regjistrimit, nga këtu e vijim referuar si “PER” e cila krijohet, mirëmbahet dhe përditësohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për këtë qëllim.

Rregullat për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë vendit janë ato të përcaktuara në vendim me nr. 10/2024 dhe 11/2024 të Komisionit Rregullator.

Platforma Elektronike e Regjistrimit (PER) dhe baza e të dhënave, administrohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote që ndodhet jashtë vendit në datën e zgjedhjeve dhe që dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë.

### **1. RRETH KQZ**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është një organ publik, i cili brenda autoritetit të tij, ushtron kompetenca administrative në mënyrë të pavarur nga organet e tjera publike e shtetërore dhe vepron në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është institucioni përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, i cili drejton dhe mbikëqyr veprimtarinë e administratës zgjedhore, monitoron veprimtarinë e subjekteve zgjedhore, organeve dhe institucioneve shtetërore dhe të medias në raport me zgjedhjet, si dhe zgjidh në rrugë administrative kërkesat apo ankesat që kanë lidhje me procesin zgjedhor.

KQZ-ja dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ruajnë bazën e të dhënave të zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për çdo palë zgjedhje.

**Kontakt:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Rruga “Ibrahim Rugova”, nr. 4, 1001, Tiranë, Shqipëri.  
Web: kqz.gov.al  
Email: info@kqz.gov.al  
Tel +355 4 4510810

**Roli i Zyrtarit për Mbrojtjen e Të Dhënave (DPO)**

KQZ ka caktuar një zyrtar/pegjegjes për Mbrojtjen e Të Dhënave (DPO) për të monitoruar përputhshmërinë me ligjet dhe standardet e mbrojtjes së të dhënave. Për pyetje ose shqetësime, kontaktoni në per shembull: pavlina.docaj@kqz.gov.al

**2. SI MBROHEN TË DHËNAT TUAJA****Masat e sigurisë në lidhje me të dhënat tuaja**

PER siguron mbrojtjen e plotë të të dhënave tuaja personale, në përputhje me rregulloret ligjore dhe standardet më të larta të sigurisë. Të dhënat personale përdoren vetëm për qëllime të realizimit të procesit zgjedhor nga jashtë. Të dhënat që ndahen janë të dhëna statistikore. Këto të dhëna ndahen me partitë politike, organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, si dhe organizatat ndërkombëtare të specializuara ose të angazhuara në mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësuesit e shteteve të huaja të akredituar në Shqipëri, si dhe median.

PER siguron mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave dhe standardet ndërkombëtare si Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR). Të dhënat personale grumbullohen dhe përpunohen vetëm për qëllime të administrimit të procesit zgjedhor, duke respektuar parimin e transparencës dhe respektuar objektin e qëllimit.

Të dhënat ruhen në mënyrë të sigurtë përmes protokolleve të avancuara të enkriptimit dhe aksesit të kufizuar vetëm për personelin e autorizuar, i cili është i detyruar të respektojë detyrimet ligjore dhe etike për mbrojtjen e privatësisë si dhe nënshkruan Deklaratën e Konfidencialitetit kur merr detyrën. Pas përfundimit të procesit zgjedhor, të dhënat do të fshihen/shkatërrohen/asgjësohen në mënyrë të pakthyeshme gjashtë muaj pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

Përdoruesit e PER kanë të drejtë të informohen mbi të dhënat e tyre, të kërkojnë korigjimin, kufizimin e përpunimit, ose fshirjen e tyre, dhe të parashtrojnë ankesa pranë KQZ. Çdo përdorim i paautorizuar i të dhënave ose shkelje e privatësisë do të trajtohet në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.

### **Njoftimi për shkeljet e të dhënave:**

Në rast të ndonjë shkeljeje të rëndë të sigurisë së të dhënave, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të njoftojë menjëherë autoritetin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe subjektet e prekura brenda 72 orëve.

Përdorimi i PER nënkupton pranimin e këtyre kushteve dhe angazhimin tonë për të mbrojtur të dhënat tuaja personale. Për çdo pyetje ose shqetësim, ju lutemi të kontaktoni në [ankesa.diaspora@kqz.gov.al](mailto:ankesa.diaspora@kqz.gov.al).

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është i ndërgjegjshëm për rëndësinë dhe sensitivitetin e të dhënave personale të çdo personi dhe i respekton ato në mënyrë rigorozë ashtu siç parashikohet në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Kjo arrihet nëpërmjet teknologjisë së avancuar për të ruajtur bazën e të dhënave. Po ashtu, KQZ kujdeset që transferimi dhe ruajtja i të dhënave të bëhet në masa të plota sigurie në përputhje të plotë me legjislacionin përkatës.

### **3. SI MBLIDHEN TË DHËNAT TUAJA PERSONALE**

Ndërveprimet e drejtpërdrejta: Këtu përfshihen të dhënat personale që ju ofroni në momentin e regjistrimit në platformën PER.

Ndërveprimet automatike: Në ndërveprimet tuaja me PER si në rastet e regjistrimit apo hyrjes në platformë të dhëna rreth pajisjes tuaj grumbullohen. Këto informacione grumbullohen duke përdorur cookies.

### **4. TË DHËNAT TUAJA PERSONALE QË MBLIDHEN**

<b>Personale</b>	<b>Jo Personale</b>	<b>Të ndjeshme</b>
Emri	Adresa IP	Fjalëkalimi
Mbiemri	Pajisja që përdoret	Pamja e fytyrës
Datëlindja	Vendodhja	
Vendlindja		
ID		
Nr personal		
Nr telefoni		
E-mail		
Adresa		

### **5. QËLLIMI I MBLEDHJES SË TË DHËNAVE**

Qëllimi i mbledhjes së këtyre të dhënave është regjistrimi dhe identifikimi i individëve që votojnë nga jashtë vendit përmes Platformës Elektronike të Regjistrimit.

Të dhënat personale që mblidhen shërbejnë ndër të tjera edhe për të verifikuar nëse është vetë zgjedhësi ai që bën kërkesë individuale në PER për t'u regjistruar në listën e zgjedhësve nga jashtë vendit, dhe që shpreh vullnetin për të votuar nga aty ku ndodhet jashtë Republikës së Shqipërisë.

## **6. TË DREJTAT TUAJA**

Çdo person, ka të drejtë të kërkojë, akses, korrigjim ose fshirjen e të dhënat personale që kanë të bëjnë me to, si dhe ka të drejtë të kundërshtojnë, në çdo kohë përpunimin e këtyre të dhënave në mbështetje të dispozitave të Kodit Zgjedhor, neni 25 pika 8 si dhe në Udhëzimin e Përbashkët nr. 1 datë 7.11.2024 “Për mënyrën e bashkëpunimit mes Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për çregjistrimin e shtetasve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në listën e zgjedhësve brenda vendit”.

Çdo qytetar ka të drejtë të:

- Informohet mbi të dhënat personale që ruhen.
- Kërkojë korrigjimin, kufizimin e përpunimit ose fshirjen e të dhënave të tij/saj.
- Parashtrijë ankesa pranë KQZ ose autoritetit kombëtar për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Përdoruesit mund të ushtrojnë të drejtat e tyre duke dërguar një kërkesë në adresën: [ankesa.diaspora@kqz.gov.al](mailto:ankesa.diaspora@kqz.gov.al)
- Në referim të nenit 25, pika 8, kur zgjedhësi që ka paraqitur kërkesë për regjistrim në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vëren se nuk është i regjistruar në këtë listë, ose regjistrimi i tij ka pasaktësi, ai ka të drejtë të paraqesë kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë deri 7 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Kërkesa, sipas kësaj pike, përjashtohet nga taksat gjyqësore. Gjykata e shqyrton dhe vendos në lidhje me kërkesën, sipas kësaj pike, brenda 24 orëve nga data e regjistrimit të kërkesës, por jo më vonë se 5 ditë para datës së zgjedhjeve. Emri dhe të dhënat e tjera të zgjedhësit, që i shtohet listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, i bashkëngjitet vendimi i gjykatës.

## **7. SI PËRPUNOHEN E NDAHEN TË DHËNAT TUAJA**

Ne përpunojmë të dhënat tuaja personale vetëm për qëllimin për të cilin jemi autorizuar sipas legjislacionit në fuqi.

Të dhënat tuaja personale nuk ndahen me palë të treta përveç se me ofruesin e shërbimit të TIK për mirëmbajtjen e “PER” sipas marrëveshjes kontraktuale mbi nivelin e shërbimit. Ne i përpunojmë dhe i ruajmë të dhënat tuaja vetëm për qëllimet për të cilat janë mbledhur. Të dhënat tuaja janë të mbrojtura nga akseset e paautorizuara, përdorimi i tyre i paautorizuar si dhe ndarja e tyre me palë të treta. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të përcaktojë në kontratën me ofruesin e shërbimit detyrimin e këtij të fundit për të mos shpërndarë të dhënat personale tek të cilat mund të ketë akses gjatë ofrimit të shërbimit të mirëmbajtjes.

Të dhënat e mbledhura janë të enkriptuara në portofolin digjital. Të dhënat personale ruhen dhe përpunohen përmes protokolleve të avancuara të enkriptimit (p.sh., AES 256-bit) dhe masave të aksesit të kufizuar. Vetëm personeli i autorizuar ka qasje në të dhënat, dhe çdo personel i përkushtuar në proces nënshkruan një Deklaratë të Konfidencialitetit. Të dhënat rreth pajisjes së përdorur gjatë aplikimit, shfletuesit të përdorur apo protokollit të internetit (IP), grumbullohen dhe përpunohen për arsye të verifikimit të përdoruesit për të rritur sigurinë ndaj qëllimeve keqdashëse. Po ashtu këto të dhëna qëndrojnë anonime dhe nuk ndahen me palë të treta.

PER në asnjë moment nuk ndan të dhënat tuaja për qëllime marketingu me asnjë palë të tretë. Po ashtu PER nuk grumbullon informacion anonim dhe jo të autorizuar rreth vendndodhjes së pajisjes suaj në momentin e aplikimit apo krijimit të llogarisë duke mbrojtur privatësinë tuaj. Gjithashtu, PER nuk mbledh apo përpunon të dhëna rreth modelit të pajisjes apo veprimtarisë së tij gjatë përdorimit të platformës. PER ruan adresën IP, pajisjen që përdoret dhe vendndodhjen vetëm në rastin kur zgjedhësi dërgon kërkesën për regjistrim.

## **8. COOKIES**

Ju mund ta konfiguroni shfletuesin/browserin tuaj që të refuzojë të gjitha ose disa cookies të shfletuesit/broëserit, ose të ju njoftojë kur faqet e internetit vendosin ose qasen në cookies.

- **Cookies:** Platforma mund të përdorë cookies për të optimizuar funksionalitetin. Përdoruesit mund të zgjedhin të refuzojnë cookies përmes cilësimeve të shfletuesit/broëser, por kjo mund të ndikojë në aksesueshmërinë e disa shërbimeve.

Të dhënat që mbledhim për ju, të dhënat personale, ose informacioni personal, nënkupton çdo informacion për një individ nga i cili mund të identifikohet ai person.

Ne nuk mbledhim dhe mbajmë të dhënat tuaja personale përveç për qëllimet e mbështetjes suaj në përdorimin e PER. Ne gjithmonë do të kërkojmë miratimin tuaj për të përpunuar të dhënat tuaja biometrike. Mbledhja, përdorimi, ruajtja dhe transferimi i të dhënave tuaja personale është i kufizuar sipas legjislacionit të zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave dhe standardet ndërkombëtare si Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR).

### **Periudha e ruajtjes së të dhënave:**

Të dhënat do të ruhen për një periudhë jo më të gjatë se 6 muaj pas shpalljes së rezultatit përfundimtar dhe më pas do të asgjësohen në mënyrë të sigurt.

## **9. NDRYSHIMET NË POLITIKEN E PRIVATËSISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur masa të sigurisë për të garantuar se të dhënat tuaja janë duke u përpunuar në mënyrë të sigurtë dhe korrekte.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ju rekomandon që t'i lexoni politikat e privatësisë të PER-it. Ne mund të përditësojmë herë pas here politikën tonë të privatësisë. Për një përditësim të tillë, ne do t'ju njoftojmë për çdo ndryshim duke postuar Politikën e re të privatësisë në këtë platformë. Ju këshillojmë që të rishikoni periodikisht këtë Politikë të Privatësisë për çdo ndryshim dhe ndryshimet në këtë politikë të privatësisë janë efektive kur ato postohen në këtë faqe.

**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** merr përsipër të ndryshojë apo modifikojë politikat e privatësisë në çdo moment, në zbatim të çdo ndryshimi të mundshëm të legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe legjislacionit specifik.

Deklaroj se do të përdor të dhënat personale vetëm për qëllimet e përcaktuara nga detyrat e mia dhe brenda kompetencave të dhëna nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, dhe nuk do të kopjoj, shpërndaj apo ruaj asnjë informacion pa autorizim të qartë nga KQZ.

### **3. Mbrojtja e të dhënave**

Angazhohem të ndjek të gjitha masat ligjore dhe teknike për të mbrojtur të dhënat nga aksesimi i paautorizuar, keqpërdorimi apo shkelja e privatësisë dhe të bashkëpunoj me çdo auditim të brendshëm ose të jashtëm sipas kompetencave të përcaktuara nga KQZ.

### **4. Kthimi dhe asgjësimi i të dhënave**

Në përfundim të detyrës, angazhohem të dorëzoj çdo material që përmban të dhëna personale dhe të mos mbaj kopje të tyre në çfarëdo forme, fizike apo elektronike

### **5. Përgjegjësia ligjore**

Kuptoj dhe pranoj që shkelja e këtij angazhimi mund të më ekspozojë ndaj masave disiplinore përfshirë pezullimin ose përfundimin e marrëdhënies së punës, si dhe ndjekje ligjore, përfshirë gjoha administrative ose ndjekje penale, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, pranoj se njoh dhe kuptoj përgjegjësitë ligjore dhe se do të jem përgjegjës për respektimin e tyre si dhe për çdo pasojë që mund të shkaktohet nga veprimet/mosveprimet e mia.

Data: \_\_\_\_\_

Vendi: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Emri dhe Mbiemri: \_\_\_\_\_